



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 160, datë 14.08.2019

PËR

**NJOHJEN DHE REGJISTRIMIN E SHOQËRISË “SMARTCOM” SH.A. SI
AGJENT I SHOQËRISË SË BROKERIMIT NË TITUJ
“RODELER” LTD**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 42, pika 10, nenit 47, paragrafi 3, pika 4, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, nenit 15 dhe nenit 8 të Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëria “Smartcom” sh.a. me Vendimin e Bordit nr. 117, datë 27.07.2017 është licencuar si shoqëri brokerimi për ushtrim veprimtarie tregtimi në tituj dhe me Vendimin e Bordit nr. 118, datë 27.07.2017 është miratuar si agjent i shoqërisë së brokerimit në tituj “Rodeler” Ltd, e licencuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros (CYSEC).

Shoqëria “Smartcom” sh.a. aktualisht, zotëron Licencën nr. 18, datë 27.07.2017, pa afat për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në tituj (blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit) në tregun e licencuar në territorin e R.SH. dhe është e regjistruar si agjent i lidhur i shoqërisë së brokerimit në tituj “Rodeler” Ltd.

Në bazë të nenit 21, të Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”, subjektet e miratuara për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shoqërisë së brokerimit të licencuar sipas Vendimit nr. 55, datë 30.03.2011, duhet të përshtatin veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi.

Meqenëse sipas nenit 8 të Rregullores, veprimtaria e agjentit është e papajtueshme me veprimtarinë e brokerimit dhe këshillimit në titujt, shoqëria “Smartcom” sh.a. me Vendimin e datës 30.04.2019 të aksionarit të vetëm të saj ka vendosur që kjo shoqëri të ushtrojë vetëm veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj, duke shprehur si rrjedhojë vullnetin për tërheqjen nga veprimtaria e brokerimit.

Ndërkohë shoqëria “Smartcom” sh.a. ka plotësuar edhe kërkesat e tjera të Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Shoqëria “Smartcom” sh.a. të vijojë veprimtarinë e agjentit në emër dhe për llogari të shoqërisë së brokerimit në tituj “Rodeler” Ltd.
2. Shoqëria “Smartcom” sh.a. njihet dhe regjistrohet për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në tituj në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”.
3. Shoqërisë “Smartcom” sh.a. i tërhiqet Licenca nr. 18, datë 27.07.2017 sipas vendimit të saj.
4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI